



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax:+355 4 2380 300/323

E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)

[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202200348/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2022

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë.

**Drejtuar:** Drejtues i parë z. Lorenc PANGANIKA  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

**TIRANË**

**Për dijëni:** z. Bujar MEHMETI  
Shef i Komisarlatit të Policisë nr.1 Tiranë

**TIRANË**

**Për dijëni:** Drejtues Madhor z. Gledis NANO  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë.

Inspektimi u krye në datën 16.03.2022, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, znj. Nertila Qafzezi dhe znj. Gloria Çarkaxhiu me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar; procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm

të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019; procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen dhe trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, z. Bujar Mehmeti, dhe përgjegjësën e dhomave të sigurisë, z. Arben Duqi, të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, shefi i komisarariatit informoi grupin e inspektimit mbi gjendjen në të cilën ndodhen ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë pranë këtij komisaritati, angazhimin e punonjësve të policisë që kryejnë detyrën në këto ambiente, për garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e policisë, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Pasi mori informacionin e nevojshëm, grupi i inspektimit i shoqëruar nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, inspektoi në vend gjendjen e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë; administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar; intervistoi personin e shoqëruar; si dhe vizitoi zyrat e punës të oficerëve të policisë gjyqësore, në lidhje me praninë e sendeve që ekspozojnë dhunë gjatë kryerjes së veprimeve procedurale për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.

Theksojmë se, drejtuesit dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë inspektimit që u zhvillua në ambientet e këtij institucioni.

Gjatë inspektimit, përgjithësisht u evidentua se punonjësit e policisë në mjediset e komisarariatit, zbatonin protokollin shëndetësor për parandalimin e përhapjes të sëmundjes infektive COVID-19. Ata ishin të pajisur me maska mbrojtëse dhe në vende të aksesueshme (korridore) ishin vendosur dezifektantë për pastrimin e duarve<sup>1</sup>.

Nga verifikimi i masave për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i kryer në datë 04.12.2019, rezultoi se:

---

<sup>1</sup> Urdhër nr. 273 datë 26.04.2022 për shfuqëzimin e urdhërit nr.351 datë 29.05.2020 “Për marrjen e Masave të Veçanta dhe Kufizimeve për Parandalimin e Përhapjes së Covid -19”.

**Ishte zbatuar rekomandimi**, sigurimin e kushteve të mira higjeno-sanitare të mjedisit dhe në dhomat ku mbahen dhe trajtohen personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

**Ndërkohë, grupi i inspektimit konstatoi se:**

1. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për sigurimin e kushteve të përshtatshme të qëndrimit dhe jetesë normale të shtetasve të ndaluar/arrestuar, që të plotësojnë standardin e trajtimit njerëzor e dinjitoz të parashikuar nga konventa dhe pajisja e dhomave të sigurisë me krevate brenda kapacitetit të tyre fizik, deri në ndërtimin e godinës/bllokut të dhomave të sigurisë për strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.
2. **Nuk ishte plotësuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambienteve të shoqërimit, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për gra, burra dhe të mitur.
3. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për ndërtimin e ambienteve të sigurisë sipas procedurave standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1102, datë 07.11. 2017. Gjithashtu duhet të menaxhohet me shumë kujdes fluksi i personave të shoqëruar për të mos krijuar mbipopullim pasi kushtet e dhomës janë të papërshtatshme.
4. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e ambienteve të nevojshme, që do të shërbejnë si zyrë më vete për marrjen në pyetje dhe intervistimin e personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, para se të dërgohen në ambientet e sigurisë.
5. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin dhe plotësimin me materialet e nevojshme të dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e sigurisë.

Në përfundim të inspektimit, grupi i monitorimit konstatoi se, në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Nr.1 Tiranë, vazhdonin të ishin të pranishme thuajse të tëra problematikat e konstatuar më parë dhe gjendja nuk ishte përmirësuar.

**Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisarjatin e Policisë nr.1 Tiranë, ambienti i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019<sup>2</sup>.

Mjedisi i shoqërimit ndodhej në katin e parë të ndërtesës dhe kishte **1(një) dhomë shoqërimi**, e cila përdorej për meshkujt madhorë ndërkohë **që nuk kishte dhomë për shoqërimin e gra dhe të të miturve**.

Mungesa e dhomave të shoqërimit të pospër gra dhe të mitur në konflikt me ligjin, siç është parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tregon për cënimin e standarteve në këtë komisarjat, që kanë të bëjnë me shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë. Në përfundim të veprimeve procedurale, nga ana e punonjësve të policisë, gra dhe të miturit, dërgoheshin menjëherë në ambientet e dhomave të shoqërimit, ndalimit apo arrestimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Dhoma e shoqërimit ishte me sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve. Ajo gjithashtu ishte e pajisur me tavolina dhe stola për të mundësuar qëndrimin ulur të personave. Përmasat e dhomave të shoqërimit ishin 4x5m me kapacitet për mbajtjen dhe qëndrimin ulur deri 5 persona.

Dritaret e dhomës së shoqërimit ishin me përmasa të tilla që lejonin mundësinë për ajrim dhe ndriçim të plotë natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dhomat ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare. Në pjesën e jashtme, dritaret ishin të siguruara me rrjetë të hollë teli, për arsye të sigurisë së personave që ndodhen në këto ambiente. Dhoma e shoqërimit nuk kishte sistem ngrohje/ftohje.

Në korridorin ku ndodheshin dhomat e shoqërimit, ishte një tualet për personat e shoqëruar, i kompletuar me lavaman dhe çezmë, si dhe kishte ujë të rrjedhshëm.

Në ambientin e shoqërimit nuk kishte dhomë të posaçme për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve. Në çdo rast, intervistimi i personave të shoqëruar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Njëkohësisht edhe kryerja e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe komunikimi i masës së sigurisë të personave për kalimin nga dhomat e shoqërimit në dhomat e sigurisë, kryhet në zyrat e punës së punonjësve të policisë.

Në këtë komisarjat ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera, **por ato nuk ishin funksionale për shkak të një gabimi teknik në aparaturë dhe për këtë arsye nuk kishte monitorim apo vëzhgim të ambienteve në këtë institucion për rreth dy vite.**

---

<sup>2</sup> Kreu VII, pika 4/d, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të Komisarariatit nr.1 Tiranë, përveç atyre mjediseve ku çënohet privatesia, është vlerësuar nga ana jonë si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, **si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve**, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të komisarariatit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet përkatëse që hartojnë institucionet monitoruese të pavarura.

Nga inspektimi i ambienteve në mjedisin e shoqërimit, nuk u gjetën sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve të personave apo për kundërveprime ndaj punonjësve të policisë.

Në kohën e inspektimit, kishte një person të shoqëruar në mjediset e policisë së këtij komisaritati, për shkak të kryerjes së veprës penale të vjedhjes. Nga intervista e kryer me personin e shoqëruar, ai nuk ngriti asnjë lloj pretendimi për mënyrën e shoqërimit, apo njohjen me të drejtat dhe mbajtjen në ambientet e këtij institucioni, por ngriti shqetësim se nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej, e cila është në kompetencë të organeve ligjzbatuese për vertetimin e akuzës së kryerjes së saj.

Ndërsa për periudhën Janar-Mars 2022 në regjistër ishin evidentuar të dhënat për 463 persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar në mjediset e këtij komisaritati, ku saktësisht ishin **404** shtetas madhor, **45** shtetase gra dhe **14** shtetas të mitur, të cilët ishin në konflikt me ligjin, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 109 dhe 112/1 të ligjit për Policinë e Shtetit. Nga sa më sipër, rezulton se në këtë periudhë në këtë komisaritat ka pasur mbipopullim të dhoma e shoqërimit pasi ndarja e të shoqëruarëve rezulton mbi 6 persona ndërsa kapaciteti ishte për 5 persona të shoqëruar në konflikt me ligjin.

Në ambientin e shoqërimit ishin vendosur postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar. Në posterat përkatës ishte pasqyruar edhe e drejta ligjore e personave të shoqëruar për të paraqitur ankesa.

Gjithashtu, na u bë me dije se personat e shoqëruar nga policia informoheshin për të drejtat e tyre, që nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacion të qartë verbal në lidhje me të drejtat ligjore/procedurale që ata kanë. **Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit**

**Kombëtar kërkon dhënien e kopjes së kartës** së të drejtave të personave të shoqëruar që në momentin e hyrjes në komisariat, për të garantuar njohuritë e këtyre individëve për të drejtat e tyre. Me keqardhje konstatojmë se ky standard i arritur në inspektimin e shkuar është përkeqësuar në këtë vit.

Nga verifikimi i regjistrit të marrjes dhe dorëzimit të personave të shoqëruar dhe kopjeve të procesverbalit të veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë me personat e shoqëruar, në rubrikën me shënimet në lidhje me ankesat/kërkesat e të shoqëruarve rezultoi se, për vitin 2022 nuk kishte asnjë ankesë të regjistruar.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, gjatë muajit mars ka monitoruar protestat e qytetarëve, të cilët shprehnin pakënaqësi në lidhje me rritjen e çmimeve në vend, ku evidentoi një numër të konsiderueshem protestuesish të shoqëruar në këtë institucion për pjesëmarrje në protestë. Gjatë ditëve të protestave të muajit mars të vitit 2022, ishin shoqëruar dhe evidentuar në regjistrin e shoqërimit 22 persona. Kjo ka sjellë si pasojë dhe mbipopullimin e dhomave të shoqërimit për personat e ndaluar/arrestuar. Në përfundim të shqyrtimit të tyre, në disa raste nga Institucioni i Avokatit të Popullit është konstatuar se e drejta e qytetarëve për protesta demokratike, nuk respektohet gjithnjë nga organet e Policisë së Shtetit në përputhje me standardet ndërkombëtare apo frymën e ligjit vendas. Këto të fundit jo vetëm që nuk kanë kontribuar në realizimin e saj, por ndonjëherë janë bërë edhe pengesë duke e cënuar këtë të drejtë themelore dhe kushtetuese të shtetasve.

Në vlerësimin tonë e drejta e qytetarëve për protesta demokratike është e drejtë absolute dhe e patjetërsueshme, e garantuar nga kushtetuta, ligjet për tubimet publike, si dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Këto shkelje të ligjit nuk cenojnë vetëm të drejtat ligjore të shtetasve të caktuar, por në të njëjtën kohë dëmtojnë imazhin dhe besimin e Policisë së Shtetit në publik. Ndërkohë është rasti që të sjellim në vëmendje shqetësimin e konstatuar prej disa vitesh nga Avokati i Popullit lidhur me faktin se oficerët e policisë gjyqësore i kryejnë veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e tyre të punës. Këto ambiente nuk janë të monitoruara me kamera për vëzhgimin e veprimeve procedurale të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore.

Në vijim të inspektimit nuk u konstatua në vend apo dokumentacion ndonjë ankesë lidhur me ushtrim dhune apo trajtim degradues. Gjatë inspektimit u këqyrën të gjitha zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore në të gjitha ambientet e komisariatit. Në zyrat e lartpërmendura nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë ndaj shtetasve që intervistohen/merren në pyetje.

Nga verifikimi i dokumentacionit në zyrën e informacionit, u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika, nga ku rezultoi se në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë, mbahej procesverbali përkatës dhe pasi firmosej, një kopje i jepej personit të shoqëruar dhe një kopje ruhej në arkivën e institucionit.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë, ambienti i sigurisë **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Grupi i inspektimit konstatoi se, në katin e parë të këtij komisariati **ndodhej vetëm 1 dhomë sigurie** për persona të ndaluar/arrestuar, me përmasa 4x2m dhe me kapacitet për 4 persona. Kjo dhomë ishte përshtatur pas rrëzimit të një muri ndarës që kishte ekzistuar më parë, duke bashkuar kështu dy dhoma ekzistuese, të vogël të cilat më parë nuk plotësonin kushtet minimale të parashkruara në rregullore.

Gjithashtu, në ambientin e sigurisë nuk kishte ambient më vete për ajrimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe mungonte ambienti që shërben si objekt kulti.

MKPT vazhdimisht ka konstatuar se qëndrimi i personave të ndaluar dhe të shoqëruar në këto kushte, kërkon kujdes të veçantë pasi vë në rrezik edhe shëndetin e tyre dhe mund të jetë burim vatrash infeksioni dhe sëmundjesh, ndaj për rrjedhojë sugjeron të tregohet kujdes i veçantë në drejtim të ruajtjes së higjenës brenda këtyre ambienteve. Ndërkohë të ndaluarit qendrojnë gjatë në këto dhoma dhe duhen të merren masa për mirësimin e kushteve.

Në korridorin e ambientit të sigurisë nuk kishte një telefon fiks, për punonjësit e policisë që shërbenin në këtë ambient, i cili të shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente. Në dhomat e sigurisë mungonte butoni zile/sinjali i montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë. Gjithashtu, në korridorin e ambientit të sigurisë mungonte sistemi i monitorimit audio-vizive me kamera, për vëzhgimin e veprimeve të punonjësve të policisë të shërbimit.

Në ambientin e sigurisë mungonte dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, si dhe dhoma për marrjen në pyetje/intervistimin e personave të arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë gjyqësore dhe për takimet me avokatët.

Sipas informacionit të drejtuesit të komisariatit, dhomat e sigurisë janë të mbyllura në mënyrë verbale dhe personat e arrestuar/ndaluar, në përfundim të veprimeve procedurale nga ana e punonjësve të policisë, dërgoheshin menjëherë në dhomat e sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, por nga ana e stafit të institucionit na u bë me dije se ata janë hapur në mars për shkak mbipopullimit që patën në komisariat për shkak të protestave të qytetarëve. Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka ngritur shqetësimin e vazhdueshëm për mbylljen e dhomave të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë, të përcaktuar sipas procedurës standarde me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, kjo pasi dhomat nuk plotësojnë standardet minimale të jetesës. Sipërfaqja e dhomave ishte më pak se 5m<sup>2</sup> për person, ndriçimi artificial ishte i papërshtatshëm dhe ajrimi ishte i pamjaftueshëm.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga CPT, gjatë vizitës inspektuese në vitin 2018 në Shqipëri, lidhur me kushtet në ambientet e sigurisë së këtij komisariati, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar: “Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e dhomave ekzistuese të sigurisë në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuar në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, si dhe zbatimi i rekomandimit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT).<sup>3</sup>

Komisariati i Policisë nr.1 Tiranë, në përgjigje të shkresës tonë, me shkresën nr.1050/1 prot, datë 01.03.2022, na informoi se nga ana e Komisaritatit të Policisë nr.1 Tiranë, janë marrë masat e menjëhershme për mbylljen e dhomave të sigurisë. Të gjithë të arrestuarit/ndaluarit që ndodheshin në ambientet e Komisaritatit nr.1 Tiranë, prej datës

---

<sup>3</sup> Rekomandime drejtuar Komisaritatit të Policisë nr.1 Tiranë, me numer prot, K4/I4-4 Prot, datë 02.02.2022, në lidhje me kushtet në ambientet e sigurisë të Komisaritatit të Policisë nr.1 Tiranë, në zbatim të detyrave të lënë nga CPT.



19.02.2022, janë transferuar pas kryerjes së veprimeve procedurale, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë duke i akomoduar në dhomat e sigurisë.<sup>4</sup>

Është rasti të theksojmë rëndësinë që ka zbatimi efektiv i rekomandimeve të lëna nga institucioni ynë në lidhje me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e komisarariatit.

Përdorimi i dhomave të sigurisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë, për persona të ndaluar/arrestuar, në kundërshtim të hapur dhe të plotë me aktet normative në fuqi, nuk duhet të kalonte pa u analizuar dhe pa nxjerrë përgjegjësitë ndaj punonjësve që kanë kryer shkeljet ligjore. Këto shkelje të ligjit cenojnë rëndë të drejtat ligjore të shtetasve të ndaluar/arrestuar në ambientet e dhomave të sigurisë.

Referuar përgjigjeve të autoriteteve shqiptare drejtuar CPT-së, thuhet se është zbatuar plotësisht rekomandimi i CPT-së, për mosmbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar në ambiente/dhoma që janë nën kubaturën dhe sipërfaqen minimale, më pak se 5m katror, në Komisarariatet e Policisë nr. 1, 2 dhe 3 të DVP Tiranë. Mbyllja dhe mos përdorimi i këtyre dhomave është bërë me urdhër të veçantë të D.P.P. Shtetit.

Gjithashtu, duhet theksuar se lidhur me plotësimin e standardeve të ambienteve të sigurisë dhe respektimin e të drejtave të arrestuarve/ndaluarve, rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato iu drejtohen. Këto rekomandime nuk iu drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është aspak serioze që me ndryshimin e titullarëve të institucioneve (Komisariateve të Policisë Tiranë) të ndryshojë edhe qëndrimi ndaj rekomandimeve të bëra më parë nga CPT dhe Avokati i Popullit, sikurse ka ndodhur dhe këtë rast me hapjen e dhomave të sigurisë në Komisariatin e Policisë nr. 1 Tiranë.

Sjellim në vëmendje se standardi i parashikuar në kërkesat e Manualit “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore” nuk ishte respektuar. Sipërfaqja e dhomave të sigurisë nuk ishte sipas standardeve 10 m<sup>2</sup>, të ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup>. Gjithashtu në dhoma nuk kishte pajisje dhe orendi të nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj.

Mjediset e dhomave të sigurisë nuk ishin të mirëmbajtura, si dhe kishin nevojë për lyerje dhe për tu mbajtur pastër nga ana higjiëno-sanitare. Po ashtu, kishte dyshek për tokë dhe ishin të vjetëruar dhe të papërshtatur për këtë qëllim. Ngjitur me dhomën e shoqërimit ndodheshet 1 tualete, e pa pajisur me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

---

<sup>4</sup> Kthim përgjigje nr.1050 prot, datë 01.03.2022 të Komisarariatit të Policisë nr.1 Tiranë.

Për sa më lart në analizë të këtij hetimi dalim në konkluzionin se, ambientet e sigurisë në këtë institucion nuk garantojnë sigurinë dhe kushtet jetësore për personat e ndaluar/arrestuar, që të trajtohen me dinjitet duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjisllacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.<sup>5</sup>

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”<sup>6</sup> dhe “Trajtimi dhe siguri i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>7</sup>, çdo njësi policore që ka dhoma shoqërimi dhe sigurie, duhet të jetë e pajisur ndër të tjera edhe me regjistrat përkatës.

Gjatë kontrollit të dokumentacionit, grupi i inspektimit konstatoi se, Komisarati i Policisë nr.1 Tiranë, ishte i plotësuar me regjistrat e përcaktuar në procedurat standarde. Ato mbaheshin në një raft në dhomën e përgjegjës të dhomave të sigurisë dhe në zyrën e informacionit, si dhe administroheshin prej punonjësve të policisë të ngarkuar me këtë detyrë. Regjistrat ishin të sekretuar dhe të plotësuar sipas rubrikave.

Konkretisht, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” bashkëlidhur procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, i cili mbahej në zyrën e informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi e shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>8</sup>.

Gjithashtu, në këtë komisarati ishte vendosur regjistri për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe të arrestimeve të kryera nga punonjësit e policisë së këtij komisarati. Gjatë periudhës 1.01.2022 deri më 16.03.2022, ishin të evidentuar 80 persona të ndaluar/arrestuar në komisaratin të Policisë nr.1 Tiranë.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e arrestimeve në flagrancë, ora e arrestimit e shënuar në procesverbalin e arrestimit, përputhej me orën e shoqërimit të tyre në mjediset e komisaratis të policisë.

---

<sup>5</sup> Dërguar rekomandimi nr. K4/I4-4 prot, datë 02.02.2022 “Në lidhje me kushtet në ambientet e dhomës të sigurisë”, në Komisaratin nr.1 Tiranë. Kthimë përgjigje të Komisaratis të Policisë nr.1 Tiranë nr.2317/1 prot, datë 04.04.2022, ku na bënë me dije se me datë 01.03.2022 është bërë mbyllja së funksionuari dhe pranimeve të ndaluarëve e arrestuarëve në dhomat e sigurisë.

<sup>6</sup> *Kreu VII, pika 5* “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>7</sup> *Kreu XI, pika 1* “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

<sup>8</sup> *Kreu VII, procedurat standarde* “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Krahas tyre, pjesë e dokumentacionit që administrohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, në zyrën e informacionit të komisariatit, ishte edhe regjistri i posaçëm për evidentimin e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin, sipas rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndërkohë, në zbatim të kërkesave të nenit 115 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, komisariati kishte edhe regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar. Për periudhën që u zhvillua inspektimi, Janar-Mars 2021 ishin evidentuar 4 kërkesa nga ana e personave të arrestuar/ndaluar me objekt për njoftimin e familjeve dhe për njoftimin e avokatit mbrojtës nga lista e miratuar nga organi i prokurorisë, të cilat (sipas shënimeve në regjistër) ishin plotësuar nga punonjësit e shërbimit në dhomat e sigurisë.

### **Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.**

Në kohën e inspektimit në ambientet e shoqërimit në Komisaratin e Policisë nr.1 Tiranë, kishte vetëm një person në cilësinë e të shoqëruarit. Ndërsa në ambientin e sigurisë ndodhej 1(një) person në cilësinë e të arrestuarit në flagrancë.

Grupi i inspektimit intervistoi personin e shoqëruar, i cili deklaroi se ishte trajtuar në mënyrë korrekte gjatë kohës së qëndrimit në ambientin e shoqërimit të komisariatit dhe ishte brenda limitit kohor të shoqërimit. Në deklaratën e personit të shoqëruar, u konstatua se, gjatë ndalimit nga punonjësit e policisë ata ishin identifikuar përpara tij duke u prezantuar me gjeneralitetet dhe detyrën që kryenin. Përsa i takon marrjes në pyetje, punonjësit e policisë së komisariatit ishin në pritje të oficerëve të policisë gjyqësore të organit të Prokurorisë për Krimet e Rënda, për vijimin e procedurave të mëtejshme.

Nga informacioni i grumbulluar gjatë inspektimit dhe kontrollit të regjistrit, nuk rezultoi asnjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik brenda ambienteve të këtij komisariati apo ndonjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e punonjësve të policisë ndaj shtetasve të ndaluar/ arrestuar, me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm, sikurse përcaktohet në nenin 133 të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar; VKM nr. 293, datë 8.4.2015 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuro-paralizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga policia e shtetit”; Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për miratimin e procedurave standarde të Departamentit të Sigurisë Publike “Për përdorimin e forcës”, si dhe në procedurën standarde për trajtimin e personave të arrestuar apo të ndaluar.<sup>9</sup>

Gjithashtu, nga intervista me personin e shoqëruar, nga ana e tij nuk pati pretendime për trajtim denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike e psikologjike. Gjendja

---

<sup>9</sup> *Kreu V, pika 6 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

psikologjike e të intervistuarit ishte e qetë dhe nuk dëshmonte për ndonjë pasojë të shkaktuar nga keqtrajtimi.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet proceduriale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto ambiente nuk ishin të monitoruara me kamera. Nga monitorimi që ju bë zyrave të punonjësve të policisë në këtë komisarlat, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale.

Ndërkohë, sikurse përmendëm edhe më lart, në këtë komisarlat nuk kishte ambiente të veçanta intervistimi, por marrja në pyetje dhe intervistimi i personave të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar kryhej në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat nuk ishin të monitoruara me kamera.

Lidhur me këto fakte, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorive Vendore të Policisë, marrjen e masave për krijimin e zyrave të posaçme, për marrjen në pyetje të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, por sikurse konstatohet nga inspektimet periodike të zhvilluara nga MKPT, ky rekomandim ende nuk është plotësuar<sup>10</sup>.

Procesi i monitorimit filmik gjatë marrjes në pyetje të personave të shoqëruar është një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprimeve të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Gjithashtu, në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë, nuk ka dhomë më vete për intervistimin e personave të mitur në konflikt me ligjin. Mekanizmi Kombëtar e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se, intervistat me të miturit duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm dhe të pajisur me orënditë e nevojshme, si tavolina dhe karrige, në një mjedis sa më të qetë, pa shtrëngime fizike dhe presione psikologjike. Në kushtet aktuale që ndodhen zyrat e punës të punonjësve të policisë, intervistimi i tyre mund të shkaktojë traumatizim plotësues te fëmijët.

---

<sup>10</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

## **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisariat, punonjësit e policisë zbatonin detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë, që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Nga inspektimi rezultoi se, për personat e shoqëruar mbahej procesverbali tip “Formulari i raportit të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit”. Njëkohësisht, zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenet 34/b, pika 2 dhe 251 të Kodit të Procedurës Penale, që të ndaluarit/arrestuarit duhet t’i jepet një kopje e procesverbalit të ndalimit/arrestimit.

Gjatë inspektimit u informuam se, personat e ndaluar/arrestuar madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat, ju ofrohej ndihmë juridike nga një avokat i caktuar kryesisht. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë.

Personave të ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj, në momentin kur hynin në ambientin e sigurisë, ju mundësohej dhënia e kartës për tu njohur me të drejtat e tyre, e cila ishte e përkthyer në 6 gjuhë të huaja.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin menjëherë për në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë, për veprime procedurale të mëtejshme, në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut në organikë të kësaj drejtorie.

Përsa i përket trajtimit mjekësor të personave ndaluar/arrestuar, u konstatua se ky shërbim ofrohej nga mjeku i cili është në organikë të DVP Tiranë. Në rastet kur këta persona kishin nevojë për vizita mjekësore tek mjekët specialistë, njoftohej menjëherë shërbimi i urgjencës kombëtare dhe personat shoqëroheshin në QSUT “Nënë Tereza”. Nga këqyrja e dokumentacionit, personat e ndaluar/arrestuar kishin kryer vizita mjekësore brenda afatit prej 12 orëve dhe sa herë është kërkuar prej tyre.

Vizitat mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit, konstatimet, rekomandimet e mjekut dhe medikamentet e dhëna, pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Ndërkohë kartelat mjekësore (kartelat ditore) vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës si dhe në ambientet e dhomave të shoqërimit të këtij Komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.”*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme për mbylljen e dhomave të sigurisë ekzistuese në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë, pasi ato nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë një trajtim njerëzor dhe dinjitoz të tyre, të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*, si dhe zbatimi i rekomandimit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës (CPT).
2. Marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit, nxjerrja e përgjegjësive përkatëse, si dhe dhënia e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës në lidhje me mosmbylljen e dhomave të sigurisë të dyllosur sipas procedurës standarde të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Njëkohësisht rekomandojmë mospërsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të ndaluar/arrestuar në ambientet e sigurisë, por trajtimi i tyre të jetë në përputhje me kriteret ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Marrjen e masave për ndërtimin e dhomave të shoqërimit në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhërin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit duke përfshirë në të ndërtimin ambienteve të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur në konflikt me ligjin.
4. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin e tualeteve të ndara për gra dhe meshkuj, si dhe të pajisura me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim, brenda apo ngjitur me ambientin e shoqërimit të Komisarifatit të Policisë nr.1 Tiranë.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për vënien dhe mbajtjen në funksion të plotë të sistemit audio-viziv me kamera në Komisarlatin e Policisë nr.1 Tiranë, i cili shërben për mbajtjen në vëzhgim të ambientit të shoqërimit dhe ambientit të sigurisë, si dhe për këqyrjen e veprimeve të punonjësve të policisë në dhomën e marrjes në pyetje apo gjatë intervistimit të personave që shoqërohen në mjedisit e këtij komisariati.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
7. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistimin e personave të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm, që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me të miturit.
8. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomën e shoqërimit, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për dhënien e kartës me të drejtat personave të shoqëruar që në momentin e shoqërimit të tyre në mjediset e komisarlatit të policisë, si dhe vendosjen e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar brenda në dhomat e shoqërimit, pasi nuk është efektive nëse janë të vendosura vetëm në korridorin e ambientit të shoqërimit.
10. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës së mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, të kompletuar me orëditë e nevojshme, si dhe pajisjen me frigorifer për ruajtjen dhe sigurimin e medikamenteve.
11. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen me telefon fiks, për punonjësit e policisë, i cili të shërbejë për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente dhe pajisjen me buton zile/sinjali të montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësën e policisë në rast nevojë.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihemi në dijeni brenda afatit **30 ditor** sipas nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**

